

V E N D I M
Nr.607, datë 30.10.1995

**PËR PAJISJEN ME “LEJE” TË SHTETASVE SHQIPTARË QË LARGOHEN NGA
TERRITORI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR MOTIVE PUNE OSE KUALIFIKIMI
NËPËRMJET PUNËS**

Në zbatim të ligjit nr.7939, datë 25.5.1995 “Për migracionin”, me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Shtetasit shqiptarë që largohen nga territori i Republikës së Shqipërisë për motive pune ose për kualifikim profesional nëpërmjet punës, për jo më pak se tre muaj, pajisen me “Leje” nga Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë.

2. Ngarkohet Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë të përcaktojë dokumentet e nevojshme për dhënien e “Lejes” dhe të nxjerrë udhëzime në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi